5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Loti I: Blerje bulmeti:

Qumeshti

(I pasterizuar dhe ambalazhuar ne tetra ose prizma pak) duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te kete karakteristikat tipike te qumeshtit i cili ka pak ngjyre te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17-19, ngarkesa mikrobike 1-2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10-12. Furnizimi do te behet sipas kerkeses se AK Bashkia Diber me mjetet e furnitorit. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetesise. Prodhimi te jete i shoqeruar me certificate te analizes te bere nga laboratorit veterinar. Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor. Pamja e jashtme: Leng i njellojte (homogjen), pa lende te huaja qe duken e notojne, ose bien ne fund. Me rrjedhje te njellojte pa nderprerje.

Ngjyra. E bardhe e njellojte me nuance te lehte te verdhe.

Shija dhe era. E kendshme, lehtesisht e embel, me shije te lehte zierje, pa shije dhe ere te huaj.

Gjalp i fresket- Bazuar ne Stazh 1445/87

Treguesit shqisore:

- 1.Pamja: E njetrajtshme, pa shtresa, ne prerje e siperfaqe te shenditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.
- 2.Ngjyra: Krem deri ne te verdhe te celur.

3. Era dhe shija: E kendshme, karakteristike e gjalpit pa ere shije te huaj.

Treguesit kimik:

Lageshtira ne %, jo me shume se 17.

Lende e thate pa yndyre ne e %, jo me shume se 2.

Kripe ne %, jo me shume se 2 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike Brenda normave te lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Amballazhimi: Amballazhohet ne kuti kartoni te valezuar me mase 1 – 5 kg, te veshur nga brenda me leter pergamen.

Mbi cdo ambalazh me gjalpe vendoset etiketa ne te cilen shenohen: Emertimi i prodhimit, Emri i produktit, Peshë neto os vëllimi i produktit, Data e prodhimit.

Kushtet e vecanta te ruajtjes

Rekomandime per perdorim, nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimore. Keto te dhena te jepen mbi ambalazh ose mbi etikete. Etiketa e produktit te ambalazhuar duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga ambalazhi. Shenimet e detyrueshme te marketimit duhet te jene te qarta, te dukshme mire, te pashlyeshme dhe lehtesisht te lexushme ne kushtet normale te blerjes dhe perdorimit.

N.q.se eshte i mbuluar me nje material veshes te gjitha informacionet e detyrueshme duhet te figurojne mbi kete te fundit ose etiketa e ambalazhit duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Emri i produktit ushqimor dhe permbajtja neto duhet te bjere ne sy qe ne pamje te pare. Nqs gjuha ne etiketen origjinale nuk eshte e pranueshme per konsumatorin per te cilin ajo eshte destinuar duhet te perdoret nje etikete shese qe permban informacionin e detyrueshem ne gjuhen shqipe. Ne rastin kur etiketa eshte zevendesuar, apo plotesuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet te jene pike per pike si te etiketes origjinale.

Malli te shoqerohet me flete analize laboratorike, certificate origjine.

Ruajtja dhe transportimi: Gjalpi ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4°C.

Transportimi i gjalpit nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike. Transportimi behet me mjet te mbuluar e te paster, i cili eshte i destinuar per transportimin e prodhimeve ushqimore.

Djath i bardhe

Kerkohet cilesia e pare prodhim vendi me baze djath nenprodukt i qumeshtit lopes, deles ose dhise.

Nuk lejohet prodhimi i djathit me perzierje qumesht pluhur.

Ngjyra sipas llojit te qumeshtit qe prodhohet djathi, nga qumeshti i lopes ngjyre krem, nga qumeshti i deles dhe dhise – ngjyre te bardhe ne krem. Lejohet djathi me perqindje yndyre jo me shume se 3 % yndyre. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze, karakteristike e djathit te stazhionuar mire.

Era karakteristike e djathit normal pa era te tjera te pa kendeshme.

Amballazhimi te jete ne rrota te rafinuara 3-5 kg.

Malli te jete i shoqeruar me certificate te cilesise dhe standarteve te miratuara.

Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, date e stazhionimit dhe data e skadimit, ne certifikate te jete shenuar edhe origjina e mallit.

-Cdo parti malli te pajiset me raport analize nga D B U M K per tu mbrojtur nga fallsifikimet qe behen per keto produkte dhe dorezohet prane magazines se Drejtorise se Spitalit Rajonal Diber, se bashku me dokumentacionin perkates.

-Dokumentat qe do te shoqerojne keto mallra do te jene: fletedaljet e shitesit me te gjithë ekstremet, certifikate sanitare – veterinare, flete analize nga inspektori veterinar

Loti II: Blerje ushqime

ARTIKULLI: SHEQER

Treguesit shqisorë.

1. **Pamja e jashtme:** Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
2. **Ngjyra:** e bardhë dhe me shkëlqim.
3. **Shija dhe era:** Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në uje të pastër.
4. **Tretshmëria:** Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1413-87.

- Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thata jo më pak se 99,6%.
- Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.
- Lagështia jo më shumë se 0,16%.
- Hiri jo më shumë se 0,07%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thasë 50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto e neto.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin SHEQER të perputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shtetëror 1413-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

ARTIKULLI ORIZ

Treguesit shqisorë.

1. **Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.

2. **Ngjyra:** E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

3. **Era dhe shija:** Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1738-87.

- Lagështia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.
- Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12%.
- Lëndë minerale nuk lejohen.
- Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %.
- Kokrra të pazhvilluara, jeshile, të pazhveshura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thasë 25-50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto ose neto.

Afati i skadences të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marre brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhëne tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin ORIZ të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shtetëror 1738-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

ARTIKULLI: MAKARONA

Treguesit shqisorë.

1.**Forma:** Makarona spageti me gjatësi jo më të vogël se 30 cm, me trashësi deri 2,4 mm.

2.**Pamja e jashtme:** Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

3.**Ngjyra:** E bardhë me nuancë të verdhë , ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

4.**Era dhe shija:** E mirë karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shteteror 1170-87.

- Lagështia jo më shume se 13%.
- Aciditeti: Acid sulfurik jo më shumë se 0,16%.
- Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
- Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

1. Në letër ambalazhi të pastër ose polietileni me masë 500 gr ose 1 kg të futura ne kuti kartoni deri në 20 kg. Në çdo pako shmangie në masë deri + - 2%.

2. Në ambalazh të jetë shënuar dhe afati i skadencës. Afati i skadences të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të kete lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që përfaqësojnë artikullin MAKARONA të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikimet teknike dhe të **Standartit Shteteror 1170-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

FASULE

Treguesit shqisorë.

1.**Pamja e jashtme:** Kokrra të plota, të shëndosha,me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale , e rrumbullakët, e gjatë etj).

2.**Ngjyra:** e bardhë.

3.**Era dhe shija:** Pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo ere tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shteteror 1723-87.

- Lageshtia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.

-
- Kokrra të thyera jo më shumë se 13%.
 - Perzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.
 - Dëmtime mekanike ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thase 25-50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lendë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto ose neto.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin FASULE të perputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikimet teknike dhe të **Standartit Shtetëror 1723-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

VAJ

Treguesit shqisorë.

- 1.Pamja në 20⁰ C : Lëng vajor, i qartë, pa depozitime.
- 2.Ngjyra : E verdhë e lehtë.
- 3.Era dhe shija : E mirë karakteristike e vajit , pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.
4. Përmbajtja e acideve yndyrore sipas S SH 203:2003.

Treguesit fiziko – kimikë.

- Dendësia relative në (20⁰ C/ujë në 20⁰ C) 0,918-0,923.
- Treguesi i refraksionit =1,461-1,468.
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj) 188-194.
- Treguesi i jodit 118-141.
- Lëndë të pasapunifikueshme : ≤ 15 gr/kg.
- Lëndët fluturuese në 105 gradë C jo më shumë se 0.2%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Vaj rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litër ose shumëfishet e tyre deri në 5 litër, të mbyllura me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Shmangia nga vëllimi është deri +- 1%.

Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet:

Emërtimi i plotë i mallit, data e prodhimit, afati i përdorimit.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë ose me material tjetër të përshtatshëm.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që përfaqësojnë artikullin VAJ të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shtetëror 203-2003**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr.9863 datë 28.1.2008.

Firma fituese do ta shoqërojë mallin me çertifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit fiziko-kimikë.

ARTIKULLI: reçel molle, fiku dhe kumbulle

Reçeli të jetë e prodhuar nga frutat me bazë molle , fiku ose kumbulle.

Të jetë i sterilizuar dhe i cilësisë së parë.

Të ketë erë të pëlqyeshme , karakteristike e frutit që mbizotëron, e ëmbël pa shije fermentimi, sipërfaqja jo e ngjitshme, jo e sheqerosur, të jetë elastike dhe e shndritshme, të mos ketë shenja myku, të ketë ngjyre të çelur.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1416-87 për marmalatën dhe sipas STASH 1477-87 për reçelin.

ARTIKULLI: Salcë domatesh

Kërkohet salcë domate e amaballazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi.

Kutia të jetë e mbyllur hermetikisht dhe e mbështjellë me etiketë të përkthyer në gjuhën shqipe kur malli është i huaj.

Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.

Përbërja e lëndës së thatë të jetë 20 % ± 1.

Nuk lejohen përbërës te tjerë dhe lëndë të huaja.

Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.

Shija të jetë karakteristike e salcës së domates pa shume aciditet.

Aroma të jetë e këndshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit.

Në etiketë të jetë shënuar qartë firma prodhuese, data e prodhimit dhe përdorimit.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1429-87.

ARTIKULLI: Kripë ushqimore

Të jetë e cilësisë së parë, e ambalazhuar në pako 0.5 deri 1 kg.

Pamja: masë kokrrizore me ngjyrë të bardhë.

Me shije karakteristike të kripur, pa shije dhe erë të huaj, e tretshme plotësisht në ujë.

Në ambalazh vendoset etiketa ku shënohet lloji i kripës, origjina e mallit.

Ruhet në vende të pastra dhe të mbrojtura nga lagështira e lëndët kimike.

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr. 9863 datë 28.1.2008.

Firma fituese do ta shoqërojë mallin me çertifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit fiziko-kimikë.

Veze

Sipas Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

Të jenë me peshë 63 deri 73 gr për /kokërr.

Të jenë të pastra, të thata, pa aroma të pakëndshme, të mbrojtura efektivisht nga tronditjet dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me diellin, sipas kërkesave specifike të higjenës bazuar në Udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazhuara në kuti kartoni ose arka. Shenjat për numrin e dallueshëm të prodhuesit, datës së skadencës të jenë mbi vezë ose mbi ambalazhin e tyre, ose mbi të dyja, ose në vende të dukshme të tyre sipas rregullores së sipërpërmendur.

NISESHTE

Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e ambalazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

MIELL GRURI

Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

E bardhë

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i ambalazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

Cunge Pule

Mish pulë e cilesise se pare, i paketuar ne kutite origjinale me vulen e garancise se skadences.Te sillet me mjete frigoriferike i gatshem per tu gatuar.

Malli te jete i shoqeruar me certifikat e cilesie me te gjithë parametrat.

VAJ ULLIRI; STASH 102- 87

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.
2. Ngjyra: të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.
3. Shija dhe era: karakteristike të vajit të ullirit. Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Aciditeti: Nuk duhet të kalojë 0. 5 %

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi duhet të jetë në shishe 0. 5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standartet.
2. Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjerë dhe konservantë.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes

7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

Çokokrem

Çokokremi Te jete cilesi ekstra,mase homogjene ne trajte kremi me kakao,lajthi,qershhi, dhe qumesht pluhur,pa konservues.

Perberesit: Qumesht pluhur, sheqer, yndyrna 26% Kakao ,lajthi 10 – 12%.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Amballazhimi hermetik me vazo plastike me peshe 1 Kg. me etikete.

BISKOTA

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Të jenë të paketuara të ndara në pako me 20 copë secila.
2. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
3. Etiketa e produktit të amballazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga amballazhi.
4. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
5. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
6. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
7. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
8. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pikë si të etiketës origjinale.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes

SODE BUKE”(STASH 1429- 87)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: me sipërfaqe të njëjlojtë ku nuk lejohen shenja myku dhe fermentimi, pa fara dhe pjesë të fermentuara.
2. Ngjyra: e kuqe, e njëjlojtë, karakteristikee zarzavatit të përdorur e të ziera.

3. Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e zarzavatit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Përmbajtja e ekstratit të dobishëm: 28 %
2. Aciditeti: jo më shumë se 0.1 %
3. Kripë NaCl: jo më shumë se 1.3 %

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi: të jetë i ambalazhuar hermetikisht në shishe qelqi, me peshë 720 gr, me etiketë ku të jenë të shënuar standartet.

MARKETIMI

2. Emërtimi i prodhuesit
 3. Emri i produktit
 4. Peshë neto ose vëllimi i produktit
 5. Data e prodhimit
 6. Data e skadencës
 7. Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit

LIMONTOZ

Pamja: Pluhur me kistale pa copa limontozi të ngjeshura, mase e derdhur dhe e thate.

Ngjyra: E badhe me shkelqim

Aroma: Pa arome

Shija: E tharte

MAJONEZE

Bazuar në SSH 1745:1987 ose ekuivalentin e tij. Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. Treguesit cilësorë: - Pamja e jashtme në temperaturë 15°C: Masë postoze ose emulsion viskoz me sipërfaqe të shndritshme. - Ngjyra: Krem me nuancë të verdhë. - Shija dhe era: Karakteristike e majonezës, pa shije dhe pa erë të huaj. Treguesit fiziko-kimik: - Lagështira në % : $12 \pm 0,5$. - Yndyrë në %: $80 \pm 0,5$. - Kripë gjelle, (NaCl) %, jo më shumë se: 1.5. - Peroksidet, miliekuivalent oksigjen aktiv për 1 kg majonezë, jo më shumë se: 15. - Acid tartrik, %, jo më shumë se: 0,65. - Mikroelementët, mg/kg majonezë, jo më shumë se: - Hekuri: 1.5; Bakri:0.1; Plumbi:0.1; Arsenik: 0.1 - Ngarkesa mikrobike: brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Analizë mikrobiologjike (bazuar në urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016) Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi bazuar në SSH 1745:1987 ose ekuivalentin e tij. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Majoneza të ambalazhohet në paketim plastik ose qelqi me vëllim 0.5 kg. Mbi çdo ambalazh do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet: - Emërtimi i prodhuesit; Emri i produktit; Peshë neto ose vëllimi i produktit; Data e prodhimit, Data e skadimit dhe Kushtet e veçanta të ruajtjes. Transporti të bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në

karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Të ruhet në frigorifer në mjedise të freskëta, të ajrosura, të pastra, të dezinfektuara, të mbrojtura nga rrezet e diellit. Verifikimi i kërkesave cilësore Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

SALCE

Bazuar në SSH 1429-1987 ose ekuivalentin e tij. Kërkesat cilësore Treguesit cilësorë: - Pamja e jashtme: Të jetë masë e njëllajtë me konsistencë paste, pa fara, pa copa lëkure, të prishura ose të fermentuara. - Ngjyra: E kuqe intensive, karakteristike e salcës së domates, e njëllajtë në të gjithë masën. - Shija dhe era: Karakteristike e domates pa shije dhe erë të huaj, pa shenja karamelizimi, prishje ose fermentimi. Treguesit Fiziko –Kimik: - Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm, sipas refraktometrit në % të jetë 28-30 % . - Aciditeti i përgjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur në acid citrik në %: jo më shumë se 8 % . - Përmbajtja sheqerit të përgjithshëm në % jo më shumë se 20%. - Kripëra të klorur natriumit, të vetë lëndës së parë, %, jo më shumë se: 1.3 % . - Përmbajtja e acidit sorbik në mg/kg, jo më shumë se: 600. - Përmbajtja e metaleve të rëndë, mg/kg produkt, jo më shumë se: Bakër 30 Kallaj 250 Zinku 20 Plumbi 0.4 Arseniku 0.4 - Aciditeti fluturues (volativ) në raport me ekstraktin, i shprehur në acid acetik jo më shumë se 0.41. - Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja. - Ngarkesa mikrobike: Brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ambalazhimi dhe etiketimi Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Salca e domates ambalazhohet në ambalazh qelqi (shishe). Lejohet shmangia me masë 3%. Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen: - Emërtimi i prodhuesit, - Emri i produkti, - Peshë neto, - Lloji, - Data e prodhimit, 41 | Faqe - Data e skadimit, - Kushtet e veçanta të ruajtjes, - Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

LENG FRUTASH

Kërkesat cilësore Frutat që përdoren të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi. Ato të jenë të pastra, të pjekura, të freskëta, të pa prekura nga dëmtuesit e sëmundjet dhe pa dëmtues mekanikë. Treguesit shqisorë: - Pamja e jashtme: Lëng me turbullirë të lehtë pa lëndë të huaja. Në pezulli lejohet turbullira e pulpës karakteristike e frutit. - Ngjyra: Karakteristike e ngjyrës së frutit me të cilin është prodhuar. - Era dhe shija: Karakteristike e frutit të përdorur. Treguesit fiziko - kimik: - Lëndë të thata, %, sipas refraktometrit, jo më pak se: $8 \pm 0,3$. - Acide organike (citrik e tartrik), %, jo më shumë se: 0.2. - Ngjyruar ushqimorë, %, jo më shumë se: 0.010. - Gaz karbonik; %, në masë jo më pak se: 0.3. Uji i sheqerit dhe gazi karbonik që përdoren për përgatitjen e pijeve freskuese të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi. Lejohet për ngjyrim, të përdoret edhe karamel (sheqer i djegur). Ambalazhimi Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Pijet freskuese ambalazhohen në shishe të pastra plastike, kërkesave të AK-së. Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen: - Emri i prodhuesit, - Peshë neto, - Data e prodhimit, - Data e skadimit, - Kushtet e vecanta të ruajtjes. 47 | Faqe Verifikimi i kërkesave cilësore Marrja në dorëzim bëhet me parti. Në çdo parti verifikohet: o Ambalazhimi dhe etiketimi; o Vetitë organo – shqisore dhe fiziko – kimike. Karakteristikat kimike dhe bakteriologjike garantojnë nga prodhuesi për çdo parti prodhimi. Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi

MOLTO/KROASAN OSE EKVIVALENTE

Moltot duhet te jene 0.45 gr, ambalazhi duhet te jete sipas fabrikes qe eshte prodhuar ku te jene te dukshme pesha, afati i skadimit, te dhenat e subjektit ku jane prodhuar. Malli nuk duhet te skadoje para 6 muajave nga data e depozimit ne AK.

VEGET

Vegeti duhet te jete i paketuar ne pako 500 gr. ambalazhi duhet te jete sipas fabrikes qe eshte prodhuar ku te jene te dukshme pesha, afati i skadimit, te dhenat e subjektit ku jane prodhuar, Malli nuk duhet te skadoje para 6 muajave nga data e depozimit ne AK.

- Artikujt e tjere te pa cilesuar me siper jane sipas specifikave te preventivit bashkeliudhur.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti I: Blerje bulmeti

Emertimi i mallit	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESI	VLERA
Qumesht i pasterizuar	liter	30 000		
Gjalp	kg	415		
Djath i bardhe lope	kg	730		

Loti II: Blerje Ushqime

Emertimi i mallit	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESI	VLERA
Cunge pule	kg	500		
makarona	kg	5500		
Oriz i paketuar 1 kg	kg	3900		
vaj lule dielli 1 liter	lt	3000		

sheqer i pakeluar 1 kg	kg	1500		
Veze mesatare	kokrra	39000		
kripe	kg	300		
Majoneze	kavanoze 0,5 kg	30		
Biskota	cope/60gr	5000		
Niseshte	kg	250		
Cokokrem	kova	300		
Salce domate 700 g	shishe	400		
Fasule	kg	1300		
Miell gruri	kg	3000		
Veget	kg	300		
Recel kavanoz	kg	500		
Sod buke	cope/100 gr	300		
Vaj ulliri	lt	230		
Limontoz	cope 100 gr	250		
Piper i zi i bluar	cope 100 gr	130		
Piper i kuq i bluar	cope 100 gr	200		
Uthull rrushi	liter	20		
Leng frutash	cope/1,5 lt	100		
Croasant me shije te ndryshme	cope/45gr.	10000		
Terhana	kg	250		
Rigon	Cope/ 15 gr	30		
Koncentrat pule (paketim 6 cope)	Cope	50		
Thjerreza	Cope/500gr	100		
Fryres keku	Cope/500 gr	200		

Afatet e lëvrimit: Lëvrimi i mallrave, është sipas kërkesave të AK duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. Ky lëvrim do të kryhet me mjetet e operatorit ekonomik fitues në adresën e Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOTIN I : Blerje bulmeti

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e ofertes sipas shtojces 1;

b. Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2020,2021 dhe 2022, ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo më e vogël se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Per kete pike 2.2.2 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në **vlerë jo më e vogël se 40%** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.1.a Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

2.3.1.b Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në përdorim ambiente të përshtatshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, ku ambienti të plotësojë kushtet higjieno-sanitare.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë License për tregtimin e produkteve blektorale (Qumesht, Gjalp, Djathe).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera, 1 (një) automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportin e mallrave, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe të plotësojë kushtet higjieno-sanitare ku për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- *Per mjetet ne pronesi: Certifikate pronesie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrollin teknik) (te vlefshme) ,siguracion (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence per transportit te mallrave.*
- *Per mjetet e marra me qera: Kontrate qeraje (te vlefshme) Certifikate pronesie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrollin teknik) (te vlefshme) ,siguracion (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence transportit te mallrave (te vlefshme).*

Shënim: Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Operatori ekonomik I shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues,ku të provohet se nga kontrolli I fundit I AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOTIN II : Blerje ushqime

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve, 2020 2021 dhe 2022, ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo më e vogël se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Per kete pike 2.2.2 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3 Kapaciteti teknik:

